



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

**FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
PROJEKTET PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT PËR TË RINJ**

Bazuar në Rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të si dhe bazuar në Vendimin nr. 1047/2019 të datës, 29.05.2019 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për thirrjen publike për Projekte për rritjen e punësimit të rinjve përmes ofrimit të shërbimeve të punësimit për të rinj, ftojmë Organizatat Jo Qeveritare/shoqërinë civile, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit në cilësinë:

- Përfaqësues nga OJQ-të (një anëtar)
- Përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit (një anëtar)

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e ndërmarrësisë, punësimit, aftësisimit profesional, apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;

- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: burim.mexhuani@rks-gov.net deri me datën 20.06.2019 dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.**